
Kurse për prindër nga ÖIF: Orientim dhe mbështetje në sistemin shkollor austriak

„Shkolla verore“, e cila u realizua nga Ministria e Arsimit për herë të parë në vitin 2020, do të vazhdojë në pushimet verore 2021. Përveç shkollës verore, Fondi Austriak i Integritit (ÖIF), do të ofrojë përsëri një kurs për prindërit dhe për personat me të drejtë kujdestarie, fëmijët e të cilëve marrin pjesë në shkollën verore. Kursi për prindër nga ÖIF zgjat 3 orë dhe përcjell njohuri dhe orientim në lidhje me sistemin arsimor në Austri dhe me suksesin e fëmijës suaj në shkollë.

Kurset për prindër nga ÖIF zhvillohen midis datave 17 maj dhe 10 shtator dhe ofrohen në të gjithë Austrinë. Kurset drejtohen nga trajnerë/e të certifikuar/a të ÖIF. Nëse është e nevojshme do të vihen në dispozicion përkthyesit/et e ÖIF. Oferta është falas për të gjithë pjesëmarrësit/et.

Në kurset për prindër do të merrni informacione të rëndësishme mbi ...

- shkollën verore 2021 (ndër të tjera mbi përmbajtjen, qëllimet, shanset),
- bazat e sistemit arsimor dhe shkollor austriak,
- mundësitë e mëtejshme të shkollimit dhe arsimimit për të rinjtë pas shkollës së detyruar (përfshirë mësimin e një zanati me maturë, prezantimin e qendrave të afërta të këshillimit),
- rëndësinë e përfshirjes së prindërve dhe personave me të drejtë kujdestarie në karrierën arsimore të fëmijëve të tyre (përfshirë shkollimin e detyrueshëm, funksionin e takimit me prindër (Elternabend), gatishmërinë për komunikimin konstruktiv me pedagogët/et, përdorimin e Schoolfox)
- mbështetjen dhe mundësitë e nxitjes për fëmijë dhe të rinj (p.sh. në rast vështirësish në të mësuar, në përgatitjen e fillimit të shkollës, në përkrahjen në gjuhën gjermane) si dhe
- mundësitë për prindërit dhe personat me të drejtë kujdestarie për të mësuar gjermanisht.

Pjesëmarrja

Për të marrë pjesë në kurse, ju lutemi kontaktoni drejtpërdrejtë me drejtorinë e shkollës.
